



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZIMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 2555 / 2 prot.

Tiranë, më 24.2.2026

U R D H Ë R

Nr. 139, datë 24.2.2026

**“PËR
MIRATIMIN E KODIT TË ETIKËS SË MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS DHE
SPORTIT”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2 të nenit 29 të Ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, si dhe të Urdhrit të Ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit nr. 314, datë 18.12.2025, “Për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e draftit të Kodit të Etikës të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit”,

U R D H Ë R O J:


1. Miratimin e Kodit të Etikës së Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij Urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen punonjësit e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij Urdhri.
3. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore për komunikimin e tij.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Blendi Gonxhja





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

KODI I ETIKËS

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza Ligjore

Kodi i Etikes hartohet në mbështetje të Ligjit nr. 90/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”*, Ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, Ligjit nr. 7961 datë 12.7.1995, *“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar, Ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar, Ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003, *“Për rregullat e etikës në administratën publike”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 874, datë 29.9.2021, *“Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”*, akteve nënligjore përkatëse dhe standardeve ndërkombëtare për etikën dhe integritetit në administratën publike me qëllim garantimin e integritetit dhe të sjelljes profesionale të nëpunësve të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit.

Neni 2

Qëllimi

Kodi i etikes ka për qëllim të përcaktoj parimet dhe rregullat e etikës, të sjelljes për të gjithë nëpunësit e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit si dhe personat e angazhuar përkohësisht në përputhje me standardet dhe interesin publik, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi dhe aktet që rregullojnë veprimtarinë e Ministrisë.

Neni 3

Fusha e veprimit

Kodi i etikes zbatohet nga të gjithë nëpunësit civilë të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, punonjësit e punësuar në kabinetin e Ministrit, praktikantët. Ky kod zbatohet si dhe personat e angazhuar përkohësisht në ushtrim funksionesh publike pranë Ministrisë, në masën që ushtrimi i funksioneve të tyre lidhet me veprimtarinë e Ministrisë.

Neni 4

Parime të përgjithshme të etikës

1. Nëpunësit udhëhiqen nga parimet e ligjshmërisë, integritetit, paanshmërisë, profesionalizmit, përgjegjshmërisë, transparencës dhe respekti për interesin publik. Nëpunësit veprojnë me ndershmëri dhe përkushtim, duke pasur parasysh vetëm interesin publik si dhe ruajtjen e besimit të publikut në institucion.

2. Nëpunësi respekton dhe zbaton me korrektësi ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, urdhrat dhe udhëzimet e brendshme duke dëshmuar integritet të lartë moral dhe profesional në funksion të plotë të ruajtjes së reputacionit dhe imazhit të institucionit.

KREU II

PARIMET THEMELORE DHE RREGULLAT E SJELLJES ETIKE

Neni 5

Vlerat Bazë Etike

1. Nëpunësi i Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit vepron në përputhje me vlerat bazë të integritetit, paanshmërisë, profesionalizmit, përgjegjshmërisë dhe respektit për interesin publik.
2. Në ushtrimin e detyrës, nëpunësi shmang sjellje ose veprim që cenon ose mund të cenojë besimin e publikut, reputacionin institucional apo perceptimin e korrektësisë dhe paanshmërisë së institucionit.
3. Nëpunësi qëndron besnik ndaj objektivave, misionit dhe parimeve të Ministrisë, duke ushtruar funksionet e tij në mënyrë të përgjegjshme dhe transparente.
4. Interpretimi i këtyre vlerave bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe parimin e proporcionalitetit.

Neni 6

Integriteti

1. Integriteti nënkupton ndershmërinë, korrektësinë, ligjshmërisë dhe besnikërisë interesit publik dhe institucionit. Nëpunësi i Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit ushtron funksionet e tij me integritet të lartë moral dhe profesional, duke respektuar ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi dhe duke shmangur çdo veprim ose mosveprim që përbën ose mund të përbëjë shpërdorim të pozitës publike.
2. Shkeljet e integritetit trajtohen sipas procedurave disiplinore të parashikuara në ligjin për nëpunësin civil.

Neni 7

Paanshmëria

1. Nëpunësi i Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit ushtron funksionet e tij në mënyrë të paanshme, objektive dhe profesionale, duke garantuar trajtim të barabartë të të gjithë personave dhe subjekteve në marrëdhënie me institucionin.
2. Nëpunësi shmang çdo situatë, veprim ose sjellje që përbën, mund të përbëjë ose duket se përbën paragjykim, favorizim apo konflikt interesi në proceset vendimmarrëse administrative.

Neni 8

Maturia

1. Nëpunësi i Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, tregon maturi vetëpërmbytje dhe përgjegjshmëri në çdo veprimtari, si dhe shmang deklarime publike që cenojnë funksionin publik kur ekziston lidhje e drejtpërdrejtë me detyrën me pozicionin e tij publik.
2. Detyrimi për maturi shtrihet në përdorimin platformave digjitale dhe forma të tjetera komunikimi publik, kur ky përdorim lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me funksionin e nëpunësit dhe/ose institucionin.
3. Nëpunësi ushtron të drejtën e shprehjes dhe të jetës private në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi. Kufizimet ndaj komunikimit publik zbatohen vetëm kur janë të nevojshme dhe proporcionale.

KREU III

RREGULLAT E SJELLJES BRENDË MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

Neni 9

Paraqitja në punë, mirësjellja dhe respekti

1. Nëpunësi paraqitet në punë me veshje dhe pamje të përshtatshme për funksionin publik që ushtron, në përputhje me Rregulloren e Brendshme të institucionit dhe normat në fuqi, duke reflektuar seriozitet, profesionalizëm dhe respekt për institucionin.
2. Nëpunësi sillet me mirësjellje korrektësi dhe respekt, pa i ngacmuar fizikisht apo verbalisht ndaj kolegëve, eprorëve, vartësve dhe çdo personi tjetër me të cilin bie në kontakt në kuadër të ushtrimit të detyrës.
3. Ndalohet çdo formë sjelljeje, veprimi ose komunikimi verbal apo joverbal që përbën ngacmim, presion, fyerje, kërcënim ose krijon një mjedis pune frikësues, armiqësor, poshtërues apo intimidues.
4. Konsiderohen ngacmime seksuale dhe trajtohen si të tilla të gjitha nga legjislacioni në fuqi, përpjekjet (avancimet) e padëshiruara, kërkesat për favore seksuale ose të tjera sjellje me natyrë seksuale, fizike ose verbale të cilat ndërhyjnë në mënyrë të paarsyeshme me punën, kushtëzon punësimin apo krijon një mjedis pune fyes apo frikësues.

Neni 10

Diversiteti dhe mosdiskriminimi

1. Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, promovon diversitetin, barazinë dhe përfshirjen, duke garantuar respektimin e dinjitetit njerëzor në marrëdhëniet e punës.

2. Ndalohet çdo formë diskriminimi, trajtimi i pabarabartë ose cenim i dinjitetit të personit, për çfarëdo shkak, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Nëpunësit kontribuojnë në krijimin e një mjedisi pune gjithëpërfshirës, të sigurt dhe respektues, në përputhje me parimet e bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për garantimin e të drejtave themelore të njeriut.

Neni 11

Përgjegjësia profesionale

1. Nëpunësi ushtron funksionet e tij brenda kufijve të autoritetit që i jepet nga pozicioni i punës dhe ligji, duke treguar nivelin më të lartë të aftësive profesionale.
2. Nëpunësi mban përgjegjësi personale për detyrat, veprimet dhe vendimmarrjet që i delegohen, edhe kur vepron në kuadër të delegimit.
3. Në rast se njohuritë e nëpunësi nuk janë të mjaftueshme për ushtrimin e një detyre të caktuar, punonjësi i Ministrisë njofton eprorin ose drejtuesin përgjegjës për detyrën e caktuar.

Neni 12

Përdorimi i pronave, i pajisjeve dhe burimeve institucionale

1. Me pronë të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, kuptohet çdo pasuri e luajtshme dhe e paluajtshme që ka në përdorim, në gëzim dhe në disponim ministria. Nëpunësi përdor pronën, pajisjet, mjetet teknologjike, sistemet informatike, postën elektronike zyrtare dhe platformat digjitale të Ministrisë vetëm për qëllime zyrtare dhe në përputhje me rregullat në fuqi.
2. Ndalohet keqpërdorimi i burimeve institucionale për qëllime personale, private, politike ose të tjera që nuk lidhen me ushtrimin e detyrës.
3. Nëpunësi mban përgjegjësi administrative për dëmtimin e pronës ose burimeve të institucionit që vjen si pasojë e pakujdesisë, përdorimit jo të rregullt apo jashtë qëllimit zyrtar. Masat merren sipas legjislacionit financiar dhe disiplinor në fuqi.

Neni 13

Raportimi i shkeljeve dhe mbrojtja e sinjalizuesve

1. Eprorët përkatës duhet të krijojnë një atmosferë të tillë që nëpunësit të ndjehen të lire të përdorin rrugët institucionale ekzistuese për zgjidhjen e problemeve apo të konflikteve të çdo lloji, si dhe të shprehin lirshëm shqetësime lidhur me situatat problematike apo konfliktuale ku ndodhen jo vetëm lidhur me marrëdhëniet e tyre brenda Ministrisë, por edhe më gjerë.
2. Nëpunësit e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit kanë të drejtën dhe detyrimin të raportojnë çdo shkelje të këtij Kodi, të legjislacionit në fuqi apo çdo sjellje që cënon integritetin institucional.
3. Raportimi mund të bëhet pranë eprorit direkt, njësisë së burimeve njerëzore ose strukturave përgjegjëse, në përputhje me legjislacionin për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

Neni 14

Privatësia

1. Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit respekton privatësinë e nëpunësve dhe mbrohet të dhënat personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Informacionet konfidenciale, përfshirë dosjet personale, të dhënat mjekësore, masat disiplinore trajtohen vetëm nga personat e autorizuar dhe vetëm për qëllime ligjore.
3. Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit ruan konfidencialitetin e çdo informacioni në përputhje me aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore, por pa cënuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, i ndryshuar.
4. Kufizimi i privatësisë lejohet vetëm kur parashikohet shprehimisht nga legjislacioni në fuqi.

Neni 15

Zbatimi i orarit të punës

1. Orari zyrtar i punës për nëpunësit dhe punonjësit e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit zbatohet në përputhje me Kodin e Punës dhe legjislacionin në fuqi për administratën publike.
2. Koha e punës përdoret vetëm për ushtrimin e detyrave zyrtare, përveç, rasteve të autorizuar shprehimisht me ligj.

Neni 16

Ruajtja e konfidencialitetit

1. Nëpunësi i Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit mbrohet sigurinë e çdo informacioni të klasifikuar të siguruar në Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit apo të prodhuar prej tij. Nëpunësi i Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit ruan konfidencialitetin e informacionit që ka në zotërim gjatë ushtrimit të detyrës së tij, apo gjatë aktivitetit në institucion, takime pune etj., pa cënuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr. 119/2014 *“Për të drejtën e Informimit”*, i ndryshuar.
2. Nëse nuk është i autorizuar nëpunësi nuk duhet që të japë, të publikojë apo të nxjerrë për përdorim publik materialet që kanë të bëjnë me politikat ose me aktivitetet e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit apo me çfarëdolloj çështje tjetër që lidhet me të dhe nuk klasifikohet si informacion për publikim për të shmangur çdo përhapje të paautorizuar të informacionit. Nëpunësi duhet të jetë i kujdesshëm në mënyrën se si e përdor atë.
3. Nuk lejohet marrja dhe dhënia e informacionit për përfitime të ndryshme ose kur përbën shkak për lindjen e konfliktit të interesave gjatë marrëdhënieve të punësimit në Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit. Gjatë marrëdhënieve të punësimit në Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, nëpunësit nuk duhet që në mënyrë të paautorizuar me ligj ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare:
 - a) Të lejojnë zbulimin ose publikimin e informacioneve, të cilat i kanë përfituar nga kryerja e detyrave të tyre;

- b) Të përdorin apo të lejojnë që ky informacion të përdoret për përfitime personale.
- 4. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit nuk pushon me përfundimin e marrëdhënies së punës, dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 17

Pijet alkoolike dhe pirja e duhanit

1. Ndalohet mbajtja e pijeve alkoolike në zyrat dhe ambientet e institucionit. Ndalohet përdorimi i alkoolit në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe/ose kur ky përdorim cenon ushtrimin e detyrës, sigurinë në punë apo mjedisin institucional.
2. Në të gjitha ambientet e institucionit është e ndaluar pirja e duhanit, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e shëndetit publik nga përdorimi i produkteve të duhanit dhe ekspozimi i pavullnetshëm ndaj tymit të tyre.

KREU IV

Neni 18

Konfliktet e interesave

1. Në respektim të parimit të moslejimit që interesat privatë të bien ndesh me pozitën e tij Publike, shmangies së konfliktit të interesave, mosshfrytëzimit të pozitës për interesin privat, moskryerjes së veprimeve arbitrare dhe tregimit të respektit të duhur për të drejtat e interesat personalë të të tretëve, nëpunësi i administratës publike ndjekë dhe zbaton këto rregulla:
 - a) Nëpunësi i administratës publike shmang çdo situatë të konfliktit të interesit gjatë përmbushjes së detyrave, deklaron interesat privatë pranë autoritetit përgjegjës të institucionit dhe respekton dispozitat e legjislacionit për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike,
 - b) Nëpunësi i administratës publike shmang angazhimin në aktivitete që përbëjnë, mund të përbëjnë apo do të përbëjnë konflikt interesi të çdo lloji, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për konfliktin e interesit;
 - c) Parandalimi, deklarimi dhe trajtimi i konfliktit të interesave bëhet në përputhje me ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.
2. Në marrëdhëniet me publikun, gjatë një procedure administrative, nëpunësi i administratës publike garanton respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave të përfshirë në mënyrë sa më efektive. Ai i informon palët mbi të drejtat e detyrimit të tyre dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose të mosveprimeve të tyre.

Neni 19

Detyrimi për vetëdeklarim ose deklarimi me kërkesë të eprorit

1. Nëpunësi ka detyrimin të deklarojë, në mirëbesim dhe në kohë, çdo interes privat që mund të ndikojë ose të duket se ndikon në ushtrimin e funksioneve të tij publike.
2. Deklarimi i interesave bëhet:
 - a) me vetëdeklarim, kur nëpunësi konstaton ekzistencën e një situatë konflikti interesi;
 - b) me kërkesë të eprorit ose të strukturës përgjegjëse, në rastet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
3. Deklarimi bëhet, si rregull, me shkrim dhe përpara përfshirjes së nëpunësit në procesin vendimmarrës përkatës.
4. Masat për parandalimin dhe trajtimin e konfliktit të interesave zbatohen në përputhje me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike dhe atkeve nënligjore në fuqi.

Neni 20

Veprimtari të jashtme

1. Nëpunësi mund të angazhohet në veprimtari të jashtme në përputhje me legjislacionin në fuqi, për sa kohë:
 - a) nuk krijohet konflikt interesi;
 - b) nuk cenohet ushtrimi normal i detyrës;
 - c) respektohen kërkesat për autorizim vetëm në rastet e parashikuara nga ligji.
2. Në asnjë rast kryerja e veprimtarive nuk duhet të çënojë reputacionin e institucionit, pavarësinë, dinjitetin dhe integritetin moral të nëpunësit apo besimin e publikut në administratën publike.

Neni 21

Kufizimet për veprimtaritë e jashtme

1. Veprimtaritë e jashtme lejohen vetëm kur nuk bien ndesh me funksionin publik dhe objektivat e institucionit. Miratimi për veprimtaritë e jashtme të nëpunësit të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit kërkohet vetëm në rastet e parashikuara nga ligji.
2. Veprimtaritë e jashtme nuk lejohen vetëm në rastet kur:
 - a) krijojnë ose mund të krijojnë konflikt interesi, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - b) pengojnë në mënyrë të qartë, të drejtpërdrejtë dhe të provueshme ushtrimin normal, efektiv dhe të paanshëm të detyrave zyrtare;
 - c) cenojnë funksionin publik, besimin e publikut ose reputacionin institucional, në një masë të tillë që tejkalon kufijtë e arsyeshëm të jetës private;
 - d) përfshijnë përdorimin e paautorizuar të informacionit, burimeve ose pozitës zyrtare.

Neni 22

Dhuratat, Argëtimet, Shërbimet për Nëpunësit

1. Gjatë marrëdhënieve të punësimit në Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit ndalohet që punonjësi të kërkojë ose të pranojë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi dhurata, shpërblime, favore, argëtime, kredi, hua ose çdo gjë tjetër që ka vlerë monetare nga persona ose subjekte që:
2. Kanë ose kërkojnë të sigurojnë përfitime në procedurat administrative në marrëdhëniet kontraktore ose në çdo marrëdhënie tjetër financiare me Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit;
3. Kryejnë transaksione ose veprimtari të cilat mbikëqyren nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit;
4. Kanë interesa që preken në mënyrë thelbësore nga kryerja ose moskryerja e detyrave zyrtare të nëpunësit të ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit.
5. Nëpunësi ka detyrimin të informojë eprorin direkt edhe në rastet kur dhurata, favori ose përfitimi refuzohet, nëse ky fakt lidhet me ushtrimin e funksioni të tij publik.
6. Rregullat për vlerën, pranimin, regjistrimin dhe trajtimin e dhuratave zbatohen në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi.

KREU V**STRUKTURA MBIKËQYRËSE E ETIKËS**

Neni 23

Struktura mbikëqyrëse e etikës

1. Mbikëqyrja e zbatimit të këtij Kodi kryhet nga:
 - a) eprorët direkt, brenda fushës së përgjegjësisë së tyre;
 - b) Drejtoria e Burimeve Njerëzore;
 - c) Komisioni Disiplinor, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Drejtoria e Burimeve Njerëzore siguron informimin periodik të punonjësve mbi Kodin e Etikës, dhe organizon aktivitetet informuese, orientuese ose trajnuese me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe parandalimin e shkeljeve etike.
3. Pranë institucionit funksionon mekanizmi këshillues etik, i cili ka për qëllim ofrimin e këshillimit konfidencial për punonjësit lidhur me zbatimin e parimeve etike, parandalimin e konfliktit të interesit dhe interpretimin e dispozitave të këtij Kodi. Ky mekanizëm ka karakter parandalues dhe këshillues, dhe nuk ushtron kompetenca disiplinore.
4. Drejtoria e Burimeve Njerëzore raporton rast pas rasti, si dhe në mënyrë periodike, Drejtorit të Përgjithshëm mbi çështjet e konstatuara në lidhje me zbatimin e Kodit të Etikës, përfshirë trendet, rreziqet etike dhe masat parandaluese të propozuara.
5. Në rastet kur nga raportimet ose verifikimet rezultojnë elementë të shkeljes disiplinore, eprorët direkt ose Drejtoria e Burimeve Njerëzore referojnë çështjen pranë Komisionit Disiplinor, i cili ndjek procedurën disiplinore në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi.

6. Çdo punonjës i institucionit ka detyrimin të bashkëpunojë dhe të raportojë pranë eprorit direkt, Drejtorisë së Burimeve Njerëzore ose mekanizmit këshillues etik për çdo situatë që lidhet me zbatimin ose shkeljen e këtij Kodi.
7. Për çdo rast të raportuar, hartohet dokumentacion përkatës, sipas natyrës së çështjes dhe dispozitave ligjore në fuqi.
8. Punonjësit ushtrojnë funksionet e tyre me përgjegjësi, transparencë dhe llogaridhënie, duke dokumentuar rregullisht veprimtarinë administrative dhe duke bashkëpunuar me strukturat e kontrollit, auditimit dhe mbikëqyrjes institucionale.

Neni 24

Dispozita zbatuese

1. Shkeljet e këtij Kodi dhe masat përkatëse disiplinore përcaktohen dhe zbatohen vetëm në përputhje me legjislacionin në fuqi për nëpunësin civil dhe marrëdhëniet e punës, si dhe rregulloren e brendshme të institucionit.
2. Për çështjet që nuk rregullohen shprehimisht nga ky Kod, zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi, duke respektuar parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe sigurisë juridike.

Neni 25

Publikimi dhe Hyrja në Fuqi

Ky Kod Etike hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit.

MINISTRI
Blendi Gonxhja

